

Pasqyrat Financiare

PRAX ALBANIA SH.A.

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

# Përbajtje

## Faqe

Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërftirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve Monetare	4
Shënimet për Pasqyrat Financiare	5-12

# Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënimë	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
		LEK	LEK
<b>Aktive</b>			
<b>Aktivet afatshkurtra</b>			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	4	-	1,698,353
Të tjera të arkëtueshme	5	1,878,623	1,871,163
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>1,878,623</b>	<b>3,569,516</b>
<b>Totali i Aktiveve</b>		<b>1,878,623</b>	<b>3,569,516</b>
<b>Detyrimet dhe Kapitali</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme	6	487,817	3,074,906
Te ardhura/shpenzime te llogaritura	7	398,508	-
Llogari të tjera të pagueshme	7	8,831,173	7,962,196
<b>Totali i Detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>9,717,498</b>	<b>11,037,102</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Llogari të tjera të pagueshme	8	-	-
<b>Totali i Detyrimeve afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i paguar		3,500,000	3,500,000
Rezervat për Investimet		(10,967,587)	(8,749,473)
Fitim/(Humbja) e vitit finanziar		(371,288)	(2,218,113)
<b>Totali i Kapitalit</b>		<b>(7,838,875)</b>	<b>(7,467,586)</b>
<b>Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit</b>		<b>1,878,623</b>	<b>3,569,516</b>

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Drejtimi më 20 mars 2022 dhe firmosur për llogari të tij nga:



*Grant Thornton Sh.p.k.*

Administrator

Përgatitur nga:



Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

	Shënim	Për vitin e mbyllur më	
		31 dhjetor 2021	
		LEK	LEK
<b>Të ardhurat</b>		-	-
<b>Total i të ardhurave</b>		-	-
<b>Minus: Shpenzimet Operative</b>			
Përfitimet e punonjësve	8	(1,020)	(10,608)
Shpenzimet administrative dhe të tjera	9	(435,809)	(2,209,818)
<b>Fitim (Humbje) nga operacionet</b>		<b>(436,829)</b>	<b>(2,220,426)</b>
<b>Të ardhura (shpenzime)financiare, neto</b>		<b>65,541</b>	<b>2,313</b>
<b>Total të ardhura (shpenzime) financiare, neto</b>	10	<b>65,541</b>	<b>2,313</b>
<b>Fitim para tatimit</b>		<b>(371,288)</b>	<b>(2,218,113)</b>
<b>Tatimi fitimi</b>	11	-	-
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>(371,288)</b>	<b>(2,218,113)</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		-	-

Pasqyra e performancës financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapital LEK	Rezerva për investime LEK	Fitimi i pashpëndarë LEK	Totali LEK
<b>Më 1 janar 2020</b>				
Balanca	3,500,000	(6,075,707)	(2,673,766)	(5,249,473)
Shpërndaria e fitimit	-	(2,673,766)	2,673,766	-
Fitimi / (numbria) e viti	-	-	(2,218,113)	(2,218,113)
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>3,500,000</b>	<b>(8,749,473)</b>	<b>(2,218,113)</b>	<b>(7,467,586)</b>
<b>Më 1 janar 2021</b>				
Balanca	3,500,000	(8,749,473)	(2,218,113)	(7,467,586)
Shpërndaria e fitimit	-	(2,218,113)	2,218,113	-
Fitimi / (numbria) e viti	-	-	(371,288)	(371,288)
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>3,500,000</b>	<b>(10,967,586)</b>	<b>(371,288)</b>	<b>(7,836,874)</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Pasqyra e Flukseve Monetare

	Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
		LEK	LEK
<b>Fitimi neto (humbja para tatum fitimit)</b>		(371,288)	(2,218,113)
<b>Rregullime per:</b>		-	-
Zhvlerësim të aktiveve afatgjata materiale			
<b>Fitimi (humbja) operative para ndryshimeve në kapitalin punues</b>		(371,288)	(2,218,113)
Ulje / (rritje) në llogarite e arkëtueshme dhe llogarite e tjera të arkëtueshme		(7,460)	(404,603)
(Ulje) / rritje në detyrimet e punonjesve		-	-
(Ulje) / rritje në llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme		(1,319,605)	4,074,671
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti operativ</b>		(1,698,353)	1,451,956
<b>Flukset neto të mjeteve monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>			
<b>Mjete monetare neto (te perdonura) ne aktivitetet investuese</b>		(1,698,353)	1,451,956
Flukset e mjeteve monetare nga aktivitet financuese			
Rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre		(1,698,353)	1,451,956
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre më 1 janar</b>		1,698,353	246,398
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor</b>	4	-	1,698,353

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Shënimet për Pasqyrat Financiare

## 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria PRAX ALBANIA SH.A.është shoqëri e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 9 shkurt 2017, në përputhje me Ligjin “Për Shoqëritë Tregtare”.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është import, eksport, transport, depozitim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të naftës.

Selia qendrore e shoqërisë ndodhet në Rr. Sami Frashëri, Kompleksin TID, Shk. B, Kati 1, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë. Ajo është regjistruar si person i tatushëm në rrethin e Tiranës me numër identifikimi të personit të tatushëm L71409020A.

Shoqëria nuk ka patur aktivitet tregtar për arsy se nuk ka marrë licensat specifike të cilat janë të nevojshme në aaktivitetin e hidrokarbureve.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 janë aprovuar nga administratorët më mars 2021.

## 2 Përbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

### 2.1 Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligji nr. 25/2018, date 10 maj 2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Këto pasqyra financiare janë shprehur në lekë, që është monedha raportuese e shoqërisë.

#### 2.1.1 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

#### 2.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje të supozimit të vijimësisë, i cili supozon se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e saj operacionale për të ardhmen e parashikueshme.

### 3 Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### 3.1 Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë para të mbajtura në bankat vendase dhe para në arke në monedhë vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto.

#### 3.2 Veprimet në monedhë të huaj

Veprimet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit sipas kursit të Bankës së Shqipërisë. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikembohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi zyrtar i këmbimit për Euro dhe USD në ALL, në fund të vitit, paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
1 EUR	120.76	123.70
1 USD	106.54	100.84

#### 3.3 Instrumentat financiare

Instrumentet financiare jo-derivative përfshijnë të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, para të gatshme dhe ekuivalente të saj, dhe të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Instrumentet financiare që përbajnë një detyrim dhe element të kapitalit neto njihen ose si detyrim ose si kapital i vet. Shoqëria ka klasifikuar si detyrim çdo hua të konvertueshme të marrë.

Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentet që nuk janë me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, çdo kosto transaksi që i atribuohet drejtpërdrejt, përveç sic përshkruhet më poshtë. Pas njohjes fillostarte, instrumentet financiare jo derivative maten sic përshkruhen më poshtë.

Një instrument finanziar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në provisionet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse shuhën të drejtat kontraktuale të Shoqërisë për rrjedhat e parave nga aktivet financiare, flukset përkatëse të parave mblidhen nga Shoqëria ose nëse Shoqëria transferon aktivin financier te një palë tjetër pa mbajtur kontroll ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare llogariten në datën kur Shoqëria zotohet të blejë ose shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuara në kontratë shuhën ose anulohen.

*Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga gjendja e parasë të gatshme, llogaritë rrjedhiëse bankare dhe depozitat bankare afatshkurtër. Për qëllimet e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë çdo depozitë të pakufizuar me maturim tre muaj ose më pak nga data e origjinës.

#### *Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me kosto minus humbjet nga zhvlerësimi. Provigioni për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtarë përcaktohet kur ka prova objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura. Vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar, dhe mospagimi ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues se llogaria e arkëtueshme është e zhvlerësuar.

Shuma e provisionit është diferenca midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara, zbritur me normën origjinale të interesit efektiv.

#### *Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e pagueshme deklarohen në vlerën e tyre të drejtë dhe më pas në koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Huatë dhe huazimet*

Huatë dhe huazimet regjistrohen në fitimet neto të marra. Çdo zbritje, premium ose diferenca të tjera midis të ardhurave neto dhe vlerës së shlyerjes amortizohet dhe përfshihet në kostot e financimit gjatë kohëzgjatjes së kredisë. Shpenzimet e interesit për kreditë llogariten në bazë të përllogaritjes. Kostot e huamarrjes shpenzohen kur ndodhin.

#### *Vlera e drejtë*

Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e saj, të llogarive, të arkëtueshmet dhe llogarive të pagueshme është e ngjashme me vlerën kontabël neto, për shkak të maturitetit të tyre afatshkurtër ose normave të interesit që përafrojnë normat e tregut.

#### *Zhvlerësimi*

Një aktiv financiar konsiderohet të jetë i zhvlerësuar nëse, ka prova objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit që ka një ndikim në rrjedhat e vlerësuara të ardhshme të parave të aktivit financiar dhe që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferençë midis vlerës kontabël të tij dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parave të gatshme zbritur me normën origjinale të interesit efektiv. Aktivet financiare individuale të rëndësishme testohen për zhvlerësim mbi baza individuale. Aktivet e mbetur financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kalim me shenjë të kundërt mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi u njoh humbja nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar, ndryshimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

Instrumentat financiare jo-derivative përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre, llogari të arkëtueshme, llogari tregtarë të pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme.

### **3.4 Inventari**

Inventari përbëhet nga mallrat e mbajtura për rishitje në rrjedhën e zakonshme të biznesit. Inventari njihet në momentin kur është në dispozicion për përdorim, kur njësia ekonomike ka kontrollin mbi inventarin, është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me inventarin do të rrjedhin në njësinë ekonomike dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri.

Inventari në njobjen fillestare matet me koston. Kostoja e inventarit përfshin çmimin e mallrave, përfshin kostot direkte siç janë transporti, sigurimi, ruajtja, detyrimet e importit, dhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për të sjellë inventarin në vendndodhjen dhe kushtet që do të përdoren siç përcaktohet nga menaxhimi. Teknikat e matjes së kostos të lejuara për inventarizim janë FIFO dhe metoda mesatare e ponderuar.

Pas njobjes fillestare në kosto, inventari matet në nivelin më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme të tij. Vlera e realizueshme neto përcaktohet si çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën e zakonshme të biznesit më pak kostot e vlerësuara të përfundimit dhe kostot e vlerësuara për të bërë shitjen.

### **3.5 Aktive afatgjata materiale**

#### *(i) Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

#### *(ii) Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përsfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### *(iii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve illogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Normat vjetore të amortizimit të aplikuara janë si më poshtë:

Aktive të qëndrueshme	%
Ndërtesa	5
Makineri dhe pajisje	20
Automjete	20
Pajisje zyre dhe të tjera	20
Kompjutera dhe pajisje IT	25

Jetëgjatësia e aktiveve dhe vlera e mbetur rishikohet në çdo datë raportimi.

### **3.6 Llogari e kërkesa të tjera të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës se mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

### **3.7 Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### **3.8 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

### **3.9 Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përvç rasteve kur lidhet me zërat e njohur direkt në kapitalin neto ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatushme për vitin, duke përdorur perqindjen e tatimit të miratuar në datën e raportimit (Shkalla e tatimit mbi të ardhurat për FY21 është 15%, FY20: 15%).

Tatimi i shtyre njihet për sa i përket diferençave të përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit finansiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore dhe ndryshimet e përkohshme të zbritshme, në atë masë sa është e mundshme që fitimet e tatushme të ardhshme të janë në dispozicion kundër të cilave ato mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në atë masë sa nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor i lidhur do të realizohet.

### **3.10 Detyrimet e pas daljes në pension dhe planet e pensioneve**

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

### **3.9 Inventarët**

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.

#### **4 Mjetet monetare**

Mjetet monetare përbëhen nga paraja dhe ekuivalentet e saj dhe janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021 LEK	31 dhjetor 2020 LEK
<b>Llogari rrjedhëse në bankë</b>		
-në monedhë vendase	-	109,519
-në monedhë të huaj	-	<u>1,588,834</u>
<b>Totali</b>	<u>-</u>	<u>1,698,353</u>

#### **5 Të tjera aktive**

	31 dhjetor 2021 LEK	31 dhjetor 2020 LEK
TVSH e arkëtueshme	1,878,623	1,871,163
<b>Totali</b>	<u>1,878,623</u>	<u>1,871,163</u>

#### **6 Të pagueshme ndaj furnitorëve**

Të pagueshme ndaj furnitorëve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqitet si vijon:

	31 dhjetor 2021 LEK	31 dhjetor 2020 LEK
Furnitorë	487,817	3,074,906
<b>Totali</b>	<u>487,817</u>	<u>3,074,906</u>

#### **7 Të tjera të pagueshme**

Të tjera të pagueshme lidhen me arkëtimet e marra në avancë dhe detyrimet tatimore, të cilat janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021 LEK	31 dhjetor 2020 LEK
Të tjera të pagueshme	8,824,849	7,956,892
Kontribute për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	6,324	5,304
Shpenzime të llogaritura	<u>398,508</u>	-
<b>Totali</b>	<u>9,229,681</u>	<u>6,477,796</u>

## 8 Kosto e punës

Kosto e punës është analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
	LEK	LEK
Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,020	10,608
<b>Totali</b>	<b>1,020</b>	<b>10,608</b>

## 9 Shpenzime administrative dhe të tjera

Shpenzimet administrative dhe të tjera analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
	LEK	LEK
Taksa & tarifa vendore	-	114,330
Sherbime konsulencë e kontabilitetit	435,809	973,118
Komisione bankare	-	39,998
Të tjera	-	1,082,373
<b>Totali</b>	<b>435,809</b>	<b>2,209,818</b>

## 10 Të ardhura / (shpenzime) financiare

Të ardhura/(shpenzime) financiare janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
	LEK	LEK
Fitimi nga kurset e këmbimit	-	(4,436)
Humbje nga kurset e këmbimit	65,541	6,749
<b>Totali</b>	<b>65,541</b>	<b>2,313</b>

## 11 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2021 (15% për vitin 2021).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore Shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Në vitin 2021 Shoqëria ka rezultuar me një fitim/(humbje) kontabël dhe fiskal si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
	LEK	LEK
<b>1 Fitimi/(humbje) para tatimit</b>	<b>(371,288)</b>	<b>(2,218,113)</b>
<b>2 Shpenzime të pazbritshme:</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>3 Fitimi/(humbje) fiskal (1+2)</b>	<b>(371,288)</b>	<b>(2,218,113)</b>
<b>4 Humbjet e mbartura (-)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>5 Norma e tatim fitimit</b>	<b>15%</b>	<b>15%</b>
<b>6 Tatim fitimi viti</b>	<b>(371,288)</b>	<b>(2,218,113)-</b>

### 13 Ngjarjet pas datës së raportimit

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit që do të kërkonte të ndryshoheshin shënimet në pasqyrat financiare.

Coronavirus (COVID-19) u konfirmua nga Organizata Botërore e Shëndetit në fillim të vitit 2020 dhe është përhapur në të gjithë Kinën kontinentale dhe në shumë vende të tjera, përfshirë Shqipërinë, duke shkaktuar ndërprerje të bizneseve dhe aktiviteteve të tyre ekonomike. Ndërsa situata po zhvillohet me shpejtësi, nuk konsiderohet e praktikueshme të sigurohet një vlerësim sasior i ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në Shoqëri. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të marrë të gjitha hapat e mundshëm për të zbutur efektet.

Asnjë ngjarje tjetër e rëndësishme nuk është identifikuar pas datës së bilancit që mund të kërkojë rregullim dhe / ose pasqyrim në pasqyrat financiare.